

VENDIM
Nr. 122, datë 24.5.2022

**MBI SHTYRJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s NË
LIDHJE ME RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “KURUM
INTERNATIONAL” SHA, ME NR. 372, SERIA F12/17, NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT
TË ERE-s NR. 106, DATË 20.7.2012, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 13, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 14, pika 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 771/2 prot., datë 18.5.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Kurum International’ sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.7.2012, i ndryshuar”,

konstatoi se:

- Në vijim të relatimit të relacionit nr. 771/2 prot., datë 28.5.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Kurum International’ sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, lindi nevoja për sqarime që lidhen me dokumentacionin financiar dhe atë teknik të aplikimit të shoqërisë dhe si e tillë vlerësohet shtyrja e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s me 20 (njëzet) ditë pune, për t’iu drejtuar shoqërisë me shkresën respektive në lidhje me dhënien e sqarimeve për këto çështje.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 20 (njëzet) ditë pune nga marrja dijeni, afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për rinovimin e licencës nr. 372, seria F12/17, të shoqërisë “Kurum International” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.7.2012.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti